

V E N D I M
Nr.483, datë 21.10.1999

**PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QENDROR PËR KONTROLLIN E KLASIFIKIMIT
PËRFUNDIMTAR TË PERSONELIT TË ADMINISTRATËS DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë” dhe vendimit nr.358, datë 28.7.1999 “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve doganorë”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Krijimin e Komisionit qendror për kontrollin e klasifikimit përfundimtar të personelit të administratës doganore me këtë përbërje:

- 1 përfaqësues nga Profesori, i cili caktohet nga
- Ministri i Financave.....Kryetar
- 1 përfaqësues nga departamenti Juridik i Kryeministrit.....Anëtar
- 1 përfaqësues nga Ministria e Financave.....Anëtar
- 2 përfaqësues nga Departamenti i Administratës Publike....Anëtarë

Titullarët e institucioneve shtetërore të lartpërmendura t’i bëjnë të njohur Ministrisë së Financave emrat e përfaqësuesve të institucioneve të tyre, brenda datës 25 tetor 1999.

Pranë komisionit ftohet të marrë pjesë si vëzhgues, një përfaqësues i Misionit të Organizatës së Sigurimit dhe Bashkëpunimit Europian në Shqipëri, i cili i paraqet një raport për punën e kryer nga ky komision edhe forumeve ndërkombëtare.

Anëtarët e Komisionit zgjidhen për një periudhë 1-vjeçare.

2. Komisioni Qendror përfiton asistencë teknike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe CAM-Albania dhe personeli i saj në përputhje me Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar nga Komisioni Europian dhe Qeveria Shqiptare më datë 10.11.1997.

3. Komisioni gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij duhet të kryejë këto detyra:

- të shqyrtojë nëse klasifikimi përfundimtar i çdo nëpunësi të administratës doganore është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikat 13.2, 13.3 e 13.4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë”;

- të shqyrtojë pozicionin e çdo nëpunësi të administratës doganore për zbatimin e dispozitave të pikës 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.358, datë 28.7.1999 “Për miratimin e strukturës së pagave të punonjësve doganorë”;

- të shqyrtojë pozicionin e çdo nëpunësi të administratës doganore për sa i përket itnegritetit moral;

- të përgatisë relacione për Drejtorin e Përgjithshëm të Doganave, për çdo nëpunës të veçantë, ku të përmbledhen rezultatet e verifikimeve të bëra dhe masat që duhet të merren, sipas Kodit Doganor dhe dispozitave të tij zbatuese, në rast se gjenden parregullsi. Një kopje e këtyre relacioneve i dërgohet Këshillit të Ministrave dhe Ministrit të Financave.

Komisioni duhet t’i kryejë detyrat e përcaktuara në këtë pikë, brenda datës 31.12.1999.

4. Komisioni ka për detyrë të verifikojë jo më pak se dy herë në vit zbatimin e procedurave të rekrutimit, të largimit nga puna dhe të shpërblimit të personelit të administratës doganore në përputhje me normat e Kodit Doganor, të dispozitave të tij zbatuese apo të urdhrave ose udhëzimeve të tjera të nxjerra në këtë fushë.

5. Në mbledhjet e Komisionit mund të marrin pjesë vetëm personat e përmendur në pikat 1 dhe 2. Në rastet kur nuk ka unanimitet midis pjesëtarëve të Komisionit vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash.

6. Për zhvillimin korrekt të detyrave të lartpërmendura, komisioni ka të drejtë të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin lidhur me personelin që ruhet në arkivat e Drejtorisë së Përgjithshme të

Doganave. Ai mund të kërkojë informacione pranë të gjitha strukturave shtetërore dhe ministrive të tjera, si edhe mund të shqyrtojë deklaratat e bëra nga personeli doganor sipas ligjit nr.7903, datë 8.3.1995 dhe vendimeve të Këshillit të Ministrave nr.38, datë 15.1.1996 dhe nr.644, datë 17.6.1996. Këto institucione shtetërore kanë për detyrë t'i përgjigjen kërkesës së komisionit.

7. Rekomandimet e komisionit janë të detyrueshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave. Në rastet kur Drejtori i Përgjithshëm refuzon të zbatojë masat e sugjeruara nga Komisioni, ai duhet t'i paraqesë një relacion me shkrim Ministrit të Financave, duke specifikuar arsyet e refuzimit. Ministri i Financave, pasi ka dëgjuar personin e interesuar, merr vendimin përfundimtar për rastin në fjalë.

8. Kundër vendimeve të Drejtorit të Përgjithshëm mund të apeloher pranë Ministrit të Financave brenda 10 ditëve nga njoftimi, duke dhënë arsyet e një ankimi të tilë. Ministri i Financave brenda 15 ditëve nga paraqitja e ankimit, merr një vendim, i cili është i formës së prerë.

9. Kryetarit dhe anëtarëve të komisionit i jepet një shpërblim për çdo mbledhje. Masa e shpërblimit caktohet nga Ministri i Financave. Efektet financiare që rrjedhin nga dhënia e shpërblimit të komisionit përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko